



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:269799

Datë: 23.02.2024

Numri i dokumentit: 05363160

C.nr.4704/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, me praktikanten M.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses Z.S. nga Prizreni, me numër personal të cilën e përfaqësojnë sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare "Klinaku", me avokatët e saj në Prishtinë, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal në Prizren, me objekt kontesti kompensimi i pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,092.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë: 23.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses Z.S. nga Prizreni me të cilën ka kërkuar që të *"Detyrohet e paditura Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal në Prizren, që paditëses, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, ti paguaj shumën prej 1,092.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm"* si e pabazuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja Z.S. nga Prizreni, përmes të autorizuarve të saj, Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare "Klinaku" me avokatët e saj nga Prishtina, në këtë gjykatë me datën 01.12.2023, ka parashtruar padi për kompensimin e pagave jubilarë, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal në Prizren, me vlerë të kontestit 1,092.00 euro.

Në padi, e autorizuara e paditëses ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, e sistemuar në vendin e punës si infermiere në Spitalin Rajonal në Prizren dhe ka mbi 20 vite përvojë pune. Duke marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale më konkretisht nenin 17 par.3 nën par.3.2, Ligjin e Punës nenet 4,10,11,55 dhe 90 dhe kontratës Individuale ka kërkuar nga e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpërblimin jubilar dhe atë në shumën prej 1,092.00 euro, kjo pasi që paga mujore e saj është në shumë prej 546 euro, ndërsa paditëses i takojnë 2 paga mujore e në shumë totale prej 1092.00euro. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Ka shtuar se paditësja kërkesën e saj e bazon në Marrëveshjen e Përgjithshme

Kolektive nenin 52 dhe 53 e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka paraparë shumë çështje nga marrëdhënia e punës. Duke shtuar se me dispozitat nga par.3 të këtij neni të Kontratës Kolektive është paraparë që shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, kjo do të thotë se shpërblimet jubilarë paguhen në afat prej një muaji prej ditës kur i punësuari mbush 10, 20 dhe 30 vite përvojë pune të pandërprerë me rastin e jubileut të ashtuquajtur vit jubilar. Pasi që paditësja marrëdhënien e punës tek i padituri e ka themeluar më 01.04.2003 ka konstatuar se paditësja tek i padituri 20 vjet përvojë pune i ka mbushur më 01.04.2023, andaj ky vit për të ka qenë jubilar, pra viti kur MPKK nuk ka qenë në fuqi. Gjithashtu ka theksuar se paditësja kërkesëpadinë e bazon në Kontratën Kolektive Sektoriale të cilës i ka përfunduar afati kohor me dt. 12.06.2021, andaj sipas kësaj paditëses nuk i takon e drejta në pagesën e shpërblimit jubilar dhe për këtë arsye ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: vërtetimet me nr.amz.1104, të datës 14.06.2023 dhe të datës 21.11.2023, kontratën e marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar me nr.amz.1104, H-59, e lidhur mes këtu paditëses Z.S. dhe të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali i Përgjithshëm “ Prim Daut Mustafa” në Prizren, Çertifikata e Kontributit Pensional të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe listën e pagave të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune, e caktuar në vendin e punës Infermiere në Spitalin e Përgjithshëm “ Prim Daut Mustafa” në Prizren.

Gjykata përmes vërtetimeve me nr.amz.1104, të datës 14.06.2023, dhe datës 21.11.2023 dhe lëshuar nga shefi i personelit në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren vërtetoi faktin se paditësja deri me dt. 21.11.2023 tek e paditura ka pasur përvojë pune gjithsej 20 vite e 7 muaj dhe 19 ditë.

Çertifikata e Kontributit Pensional të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë gjykata vërtetoi gjendjen mesatare të pagës së paditëses për muajin gusht 2023, shtator 2023 dhe tetor 2023, ndërsa nga lista e pagave të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës u vërtetua që paditësja ka realizuar pagë mujore në shumë prej 546.00 euro

Vërtetimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë vërtetimet janë të lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, provat e lartcekura gjykata ia fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kontratën Kolektive Sektoriale (KKS) të vitit 12.06.2018 e aplikueshme për periudhën kohore nga data 11.06.2018 - 10.06.2021.

Në rastin konkret pala paditëse e ka bazuar kërkesën për kompensimin e pagës jubilarë në Kontratën Kolektive Sektoriale (KKS), mirëpo gjykata duke u bazuar në nenin 2 të KKS (mbi afatin e zbatimit të kontratës) dhe Mendimin Juridik, për shpërblimin jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 27.02.2023, ku në pikën V përcaktohet që kontrata kolektive sektoriale, aplikohet për periudhën kohore nga data 11.06.2018 - 10.06.2021, ndërsa në pikën IX të po këtij mendimi juridik parashihet që *“punëtorët shëndetësor në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 17 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën V, të këtij mendimi juridik dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore te punëdhënësi i fundit”*.

Në bazë të lartcekurave gjykata konstaton se paditësja në periudhën për të cilën aplikohet kontrata kolektive sektoriale (11.06.2018 - 10.06.2021) nuk ka arritur 20 vite të përvojës së punës, kusht i kërkuar sipas nenit 17 të Kontratës Kolektive Sektoriale, për fitimin e shpërblimit jubilar prej dy pagave mujore. Nga shkresa e lëndës dhe vërtetimet e bashkangjitura në padi rrjedh se paditësja ka filluar punën tek e paditura me datë 01.04.2003 dhe e njëjta vitin e 20-të jubilar ka arritur në vitin 01.04.2023 në kohën kur nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale dhe si e tillë kjo kërkesë nuk ka bazë ligjore për tu aprovuar.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija.”*.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, pasi që e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Nga arsyet e cekura me lart dhe bazuar në dispozitat e nenit 399 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4704/2023, datë 23.02.2024

Gj y q t a r j a
Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej (7) shtatë ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.